



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM
Nr. 107, datë 24.07.2014

PËR
MASA KORRIGJUESE NDAJ SHOQËRISË SË SIGURIMIT
SIGMA V.I.G SH.A. NGA ANALIZA E VITIT 2013 DHE TREMUJORIT
TË PARË TË VITIT 2014

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pikës 2) dhe pikës 21) si dhe nenit 32 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” i ndryshuar dhe nenit 149, pikës 1), të Ligjit nr. 52/2014, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit “ me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Departamentit të Çështjeve Juridike, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E :

Shoqëria “Sigma V.I.G” sh.a. ka kryer veprimtarinë e sigurimit gjatë vitit 2013 dhe 31.03.2014 bazuar në kërkesat e Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”.

Analiza e gjendjes financiare më 31.12.2013 dhe tremujorit të parë të vitit 2014, e shoqërisë së sigurimit “Sigma V.I.G” sh.a., është kryer mbi bazën e pasqyrave financiare të raportuara në AMF. Referuar konkluzioneve të analizës financiare rezulton si më poshtë:

- Aftësia paguese e shoqërisë për periudhën 31.12.2013 është në masën 244,766,602 lekë dhe për periudhën 31.03.2014 është në masën 186,261,603 lekë. Pra *shoqëria nuk zotëron aftësi paguese në të dyja periudhat* në kundërshtim me kërkesat e nenit 96 e vijues të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004.
- Raporti i shpenzimeve për periudhat 31.12.2013 dhe 31.03.2014 është jashtë limiteve të lejuara;
- Shoqëria e sigurimit “Sigma VIG” sh.a., nuk ka llogaritur saktë provigjonin teknik për të gjitha kontratat e marra në sigurim dhe risigurim, në përputhje me kërkesat e Rregullores nr. 9, datë 08.02.2007, e ndryshuar, si dhe Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për mënyrën e përllogaritjes së provigjonit teknik të primit të pafituar, lidhur me kontratat e sigurimit pagesa e primit të së cilave bëhet me këste.

Referuar konkluzioneve të analizës financiare për shkeljet e dispozitave të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004, të ngjashme me parashikimet e Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, masat e mbikëqyrjes për shkeljet e mësipërme bazohen në Ligjin nr. 52/2014, datë 22.05.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Shoqëria “Sigma V.I.G” sh.a., ndodhet në rrethanat e përcaktuara në nenin 150, pika 1), ghermat d) dhe i) të Ligjit nr. 52/2014, datë 22.05.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Për sa më sipër Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Bazuar në nenin 152, pikën 1) ghermën b) të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” nxjerrjen e urdhërit për shoqërinë “Sigma V.I.G” sh.a. për eliminimin e shkeljeve dhe të parregullsive, të dispozitave të nenit 150, pikës 1), ghermat d), dhe i) si dhe nenit 151, ghermat a), d) dhe e) të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” si më poshtë:
 - a) Të urdhërohet Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë, bazuar në nenin 153, pikën 1, ghermën a) të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, për të zbatuar një plan veprimi, i cili garanton nivelin e fondit të garancisë;
 - b) Të urdhërohet Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë, bazuar në nenin 153, pikën 1, ghermën c) të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, të thërrasë mbledhjen e përgjithshme të asamblesë dhe t’i propozojë marrjen e vendimeve përkatëse;
 - c) Të urdhërohet Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë, bazuar në nenin 153, pikën 1, ghermën e), nëndarja viii) të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, marrjen e çdo mase të nevojshme për zbatimin e rregullave të menaxhimit të rrezikut.
2. Bazuar në nenin 153, pikën 4), dhe nenin 154, pikën 1) të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, shoqëria Sigma V.I.G sh.a., të eliminojë shkeljet dhe parregullsitë dhe të depozitojë në Autoritet një raport brenda datës 30.12.2014.
3. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Enkeleda SHEHI